



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
K R Y E T A R I

Nr.776/12 Prot.

Tiranë, më 15/12 /2017

V E N D I M

Nr.169, datë 15 / 12 /2017

PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË KRUIJË “PËR AUDITIMIN E
PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË” PËR PERIUDHËN 01.01.2015
DERI 30.07.2017.**

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Krujë rezultoi që, të ketë devijime nga kuadri ligjor rregullator në fuqi (kriteret) dhe për përmirësimin e gjendjes i janë rekomanduar Bashkisë Krujë marrja e masave organizative.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Krujë, për periudhën 01.01.2015 deri më datën 30.06.2017 dhe 5 - ish-Komuna dhe Bashki, periudha nga data 01.01.2013 deri 31.07.2015.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

A. KONKLUZIONE/OPINIONE:

Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në standardet e INTOSAI-t dhe Manualit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në *Bashkinë Krujë*, rezultuan devijime nga kuadri ligjor rregullator në fuqi (kriteret) dhe konkretisht:

1- *Bashkia Krujë*, Në pasqyrat financiare (bilancet kontabël datë 31.12.2015) ish-Komuna Thumanë, nuk ka pasqyruar në llogarinë 468 “Debitor të ndryshëm”, shuma 16,767,513 lekë, e cila vejnë nga rekomandimet e lëna nga KLSH, si dhe në ish-Komunës Çudhi, në shumën 311,671 lekë, e cila vejnë nga Auditimi i Prefekturës Durrës, ndërsa këto llogari nuk ndodhen në bilancin e datë 30.06.2015.

2- Bashkia Krujë, për vitet 2015-2016 deri me datë 30.06.2017 nuk ka evidentuar borxhin tatimor në vlerën 173,175 mijë lekë, duke mos zbatuar procedurat e arkëtimit dhe nxjerrjen e urdhër bllokimeve në bankë, apo ndjekja e rrugëve ligjore për arkëtimin e tyre.

3- Bashkinë Krujë, megjithëse është bërë transferimi i pronave dhe asetëve me VKM, nuk ka kryer inventarizimin për regjistrimin në ZVRPP Krujë.

4- Bashkia Krujë, në 7 raste me vlerë 2,065,000 lekë nuk ka bërë hyrje në magazinë studime dhe projektme të prokuruar me fonde publike, nuk ka kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e debitorëve në shumën 201,220,723 lekë, si dhe në fund të vitit 2016 nuk ka paguar detyrimet kreditore në shumën 118,125,375 lekë.

5- Bashkia Krujë, për vitin 2016, nuk ka hartuar një program vjetor për kryerjen e inventarizimit me synim sigurimin para dhe gjatë kryerjes së inventarizimit të pronës shtetërore për një mekanizëm kontrolli, bazuar në informacionin historik apo të pritshëm mbi situatat e aktiveve afatgjata për arritjen e objektivave të tyre.

6- Bashkia Krujë, aktivet e qëndrueshme qarkulluese të vlerësuar dhe të nxjerra jashtë përdorimit nuk i kabërë hyrje në magazinë me dokumentacion të rregullt kundrejt plotësimit të fletëhyrjes, si dhe komisioni i asgjësimit materialet për asgjësim nuk i ka marrë me fletëdalje nga magazina.

7 - Bashkia Krujë, shkarkimin e magazinës në lidhje me materialet e asgjësuar e ka kryer në mënyrë fiktive, pasi fletë dalja nr. 141, datë 10.0.2017, me vlerë 24,409,998 lekë, nuk ka marrës në dorëzim, duke i bërë dalje nga magazina me nënshkrimin e magazinierit.

8- Bashkia Krujë, nuk ka bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata nr. 156/1, datë 20.04.2007 e subjekti “F K C.F.” sha dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjorë Krujë, për dhënien në përdorim të sipërfaqes 3.5235 ha, parcela nr. 87-90 për prodhimin e inerteve çakull dhe gurë gëlqeror për vlerën 8,657,508 lekë.

9- Bashkia Krujë, nuk kanë lidhur kontrata për shfrytëzimin e fondit pyjor nga subjekte të ndryshme me sipërfaqe 627.725 ha të cilët kanë marrë leje shfrytëzimi MEI, që përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 275,926 mijë lekë.

Këto devijime nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur të KLSH, nuk janë materiale por devijime të konstatuara në disa raste, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar dhe për përmirësimin e gjendjes i është rekomanduar bashkisë Krujë marrja e masave organizative.

B. MASA ORGANIZATIVE

1 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë, ka dërguar në Ministrinë e Financave deklaratën, pyetësonin dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, pa informacionin e Drejtorive vartëse, ndërsa sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, në kundërshtim me pikën 15, germa b, të UMF nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike” (*Trajtuar hollësisht në faqet 10-12, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1- Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa, të dërgoj në Ministrinë e Financave deklaratën, pyetësonin dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe informacionin e Drejtorive vartëse.

Në vijimësi

2 - Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Financës në faturën tatimore të shitjes nr. 36, datë 26.05.2015, për objektin: “Sistemim i brendshëm i tregut” nuk ka bërë hyrje në magazinë 25 copë tavolina me vlerën 148,750 lekë, me konstruksion hekuri me llamarinë, si dhe nuk ndodhet licenca e operatorit ekonomik, kontrata e lidhur ndërmjet palëve, situacioni përfundimtar i punimeve edhe procesverbali i marrjes në dorëzim nga komisioni i bashkisë, veprim në papajtueshmëri me germa a pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, me pikën 42, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për

menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 27-27, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 - Rekomandimi: Bashkia Krujë, të marrë masa, të bëjë hyrje në magazinë 25 copë tavolina me vlerën 148,750 lekë me konstrukcion hekuri me llamarinë dhe të kërkojë plotësimin e dokumenteve si: licencën e operatorit ekonomik, kontrata e lidhur ndërmjet palëve, situacioni përfundimtar i punimeve edhe procesverbali i marrjes në dorëzim nga komisioni i bashkisë.

Brenda muajt Janar 2017

3 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë në 5 raste me vlerë 961,650 lekë, ka zhvilluar ngjarje kulturore dhe artistike pa hartuar program, nuk ka përcaktuar fondin limit dhe datën përfundimtare për paraqitjen e ofertave nga operatorët dhe agjencitë. Komisioni, nuk ka kërkuar oferta nga operatorët e specializuara, nuk ka përcaktuar kushtet e veçanta, si dhe nuk ka hartuar një raport të hollësishëm për të gjithë procedurën e ndjekur, raport të cilin duhet t’ia paraqiste titullarit të institucionit, veprim në papajtueshmëri me pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe VKM nr. 1173, datë 06.11.2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura” (*Trajtuar hollësisht në faqet 27, 28-29, 32 -34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1 - Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa, për ngjarjet kulturore dhe artistike të hartoj program pune, të përcaktoj fondin limit dhe datën përfundimtare për paraqitjen e ofertave nga operatorët dhe agjencitë. Komisioni të kërkojë oferta nga operatorë të specializuara, si dhe të hartojë një raport të hollësishëm për të gjithë procedurën e ndjekur, raport të cilin t’ia paraqes titullarit të institucionit.

Në vijimësi

4 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë, për periudhën Janar 2015 deri me datë 30.06.2017, për punonjësit e larguar nga puna ish-Bashkia Krujë dhe ish-komunat ka paguar sipas vendimeve të Gjykatës së Apelit Tiranë, vlerën 24,814,770 lekë, që përbën shkelje të disiplinës financiare me efekte negative në buxhetin e Bashkisë, pagesa është bërë pa u shprehur Gjykata e Lartë Kolegji Administrativ Tiranë, veprim në papajtueshmëri me neni 12 pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

Bashkia Krujë, për periudhën Nëntor 2015 deri me datë 30.06.2017, ka larguar nga puna punonjës me Statusin e Shërbimit Civil dhe me Kontratë Pune, me një efekt negative në buxhetin e Bashkisë në vlerën 13,828,835 lekë, veprim në papajtueshmëri me nenin 12 germa a pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar, të ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 30-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1 - Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa, që pagesën për punonjësit e larguar nga puna ta bëjë pasi të shprehet me vendim Gjykata e Lartë Kolegji Administrativ Tiranë, si dhe të mos largoj nga puna punonjës me status të nëpunësit civil, pasi për një vend pune paguhen dy punonjës.

Në vijimësi

5-Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Financës, sistemi kompjuterik nuk e ka të certifikuar nga kompani e licencuara për ruajtjen e të dhënave, pasi sistemi kompjuterik nuk mbron asetet dhe nuk ruan integritetin e të dhënave. Mos certifikimi i sistemit kompjuterik për mbrojtjen e të dhënave dhe të integritetit të tyre, vjen në papajtueshmëri me ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik” (*Trajtuar hollësisht në faqet 35-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1 – Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa, të certifikoj sistemin kompjuterik nga kompani të licencuara për ruajtjen e të dhënave, të mbroj sistemin kompjuterik dhe asetet duke ruajtur integritetin e të dhënave, financiar dhe çdo informacion origjinal, plotësues dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike.

Brenda muajt Janar 2017

6 - Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Financës, në Ditarin e magazinës ka regjistruar fletë hyrjen nr. 18, datë 11.03.2017, mallra për tjetërsim (skrap), ndërsa shuma e fletë hyrjes në ditarin e magazinës është në vlerën zero lekë, si dhe nuk ka bërë hyrje në magazinë projekte të financuara me buxhetin e bashkisë në vlerën 2,183,200 lekë, veprim në papajtueshmëri me germën dh, e, f, pikë 3 neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me pikën 36, 37, 39, dhe 102, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 35-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1 - Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa, të regjistrojë në Ditarin e magazinës shumë e fletë hyrjes nr. 18, datë 11.03.2017, mallra për tjetërsim (skrap), si dhe të bëjë hyrje në magazinë hartimin e projekteve në vlerën 2,183,200 lekë, të cilët janë paraqitur në Bilancet kontabël të vitit ushtrimor.

Menjëherë

7 - Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Financës, nuk ka kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e debitorëve në shumën 201,220,723 lekë, nga të cilët 160,509,164 lekë janë debitor nga tatim taksat, si dhe në fund të viti 2016 nuk ka shlyer detyrimet kreditore në vlerën 118,125,375 lekë, veprim në papajtueshmëri me germa g, gj neni 12, të ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 38-39, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1 - Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Krujë të marrë masa, të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e debitorëve në vlerën 201,220,723 lekë, nga të cilët 160,509,164 lekë janë debitor nga tatim taksat.

7.2 - Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Krujë të marrë masa, të bëjë shlyerjen e detyrimeve kreditore në vlerën 118,125,375 lekë, brenda afateve ligjore.

Në vijimësi

8 - Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Financës, në Pasqyrat Financiare të Konsoliduar datë 31.12.2015 nuk ka kërkuar nga ish-Komuna Thumanë, gjendjen e llogarisë 468 “Debitor të ndryshëm” në shumën 16,767,513 lekë, të lënë nga KLSH-ja, si dhe nga ish-Komuna Cudhi, gjendjen e llogarisë 468 “Debitor të ndryshëm” në shumën 311,671 lekë, të lëna nga Audit i Prefekturës Durrës, për periudhën e audituar nga viti 2011 deri në vitin 2014, veprim në papajtueshmëri me nenin 9 pika 1 e 2, nenin 10 pika 1 e 2 dhe neni 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” (*Trajtuar hollësisht në faqet 40-46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1 - Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Krujë të marrë masa, të paraqes në Pasqyrat Financiare të vitit 2017, në llogarinë 468 “Debitor të ndryshëm” vlerën 16,767,513 lekë, për ish-Komunën Thumanë dhe vlerën 311,671 lekë, për ish-Komunën Cudhi.

Brenda muajt Janar 2018

9 - Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Financës, për vitin 2015-2016, nuk ka bërë rivlerësimin e pasurve të paluajtshme të transferuara me çmimin e tregut, si dhe nuk i ka pasqyruar në aktivet e qëndrueshme të trupëzuara në bilanc si: tokë, troje, terren, pyje, kullota, plantacione, tokë bujqësore, ndërtesa, vendstrehime etj., me qëllim vënien në eficienës të tyre dhe sigurimin e të ardhurave për buxhetin e Bashkisë.

Komisioni i inventarizimit nuk ka hartuar një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, duke përcaktuar kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, aktivet që vlerësohen e nxirren jashtë përdorimit nuk i ka grumbulluar në magazinë me fletëhyrje, si dhe materialet që i ka asgjësuar nuk i ka marrë me fletëdalje nga magazina.

Drejtoria e Financës shkarkimin e magazinës për aktivet e asgjësuara me vlerë 24,409,998 lekë, e ka bërë pa nënshkrimin e marrësit në dorëzim (komisioni i asgjësimit), ndërsa fletë dalja është nënshkruar vetëm nga magazinieri. Në fletë dalje nuk janë përshkruar aktivet e dala për asgjësim si: njësi, sasi, çmim, vlerë, por është vendosur shënimi bashkëngjitur lista e materialeve që do të

asgjësohen, veprimet e mësipërme vijnë në papajftueshmëri me germën ë pikë 3 neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me pikën 35, germën c pika 36, 37, 39, 40, 85, 103, 104, 106, 109, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 46-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1 - Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masat e mëposhtme:

a. të bëjë rivlerësimin e pasurive të paluajtshme të transferuara me çmimin e tregut, si dhe ti pasqyrojë në aktivet e qëndrueshme të trupëzuara të bilancit si: troje, terren, pyje, kullota, plantacione, tokë bujqësore, ndërtesa, vendstrehime etj.

b. komisioni i inventarizimit të hartojë raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, duke përcaktuar kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës. Komisioni, aktivet që vlerësohen e nxirren jashtë përdorimit t’i grumbulloj në magazinë me fletëhyrje, ndërsa materialet për asgjësim t’i marrë me fletëdalje nga magazina.

c. të bëjë shkarkimin e magazinës për aktivet e asgjësuar sipas fletë dalja të nënshkruhet nga marrësi në dorëzim (komisioni i asgjësimit), duke përshkruar aktivet e dala për asgjësim si: njësi, sasi, çmim, vlerë, por është vendosur shënimi bashkëngjitur lista e materialeve që do të asgjësohen.

Në vijimësi

10 - Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Krujë, nuk ka hapur regjistra për abonentët familjarë, mungojnë njoftim detyrimi për taksat dhe tarifave vendore, për evidentimin e numrit të familjeve që duhet të paguajnë, veprim në papajftueshmëri me pikën 7 neni 3, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 128-129, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1 - Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Krujë të marrë masa, për krijimin e regjistrit elektronik me të dhëna, për: hapjen e kartelave individuale të abonentëve familjarë, hartimin e regjistrit themelorë të abonentët familjarë për taksat e tarifave vendore, duke evidentuar detyrimet për çdo taksë.

Në vijimësi

11 - Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Krujë dhe 4 Njësitë Administrative Fushë Krujë, Thumanë, Nikel dhe Bubq, në fund të vitit 2016 janë debitorë për taksat dhe tarifave vendore 1257 subjekte në shumën 160,509,164 lekë dhe 4474 familje në vlerën 3,096,000 lekë. Drejtoria e Tatim Taksave për arkëtimin e debitorëve nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore, veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenet 90, 91, të ligjit nr. 9920 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenin 12, të UMF nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve (*Trajtuar hollësisht në faqet 118-119, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1 - Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Krujë të merren masa, për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe të bëhen njoftim vlerësimet tatimore, për 1257 subjekte debitorë në shumën 160,509,164 lekë (sipas Aneksit 6 dhe 7) bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a - Tu dërgohen bankave urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

b - Të dërgoj në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

c - Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamata vonesa (gjohë në masën 0,06 % kamata vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin

114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

d-Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182, të ligjit të Kodit Penal në RSH i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative të bëhet kallëzim penal.

11.2 - Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Krujë, të listohen në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të merren masa për arkëtimin e taksave të tokës për vlerën 3,096,000 lekë, të ndarë si më poshtë:

- Njësia Administrative Fushë Krujë, taksë toke për 902 familje me vlerë 757,000 lekë;
- Njësia Administrative Thumanë, taksë toke për 1719 familje me vlerë 1,244,000 lekë;
- Njësia Administrative Nikël, për 1045 familje me vlerë 995,000 lekë;
- Njësia Administrative Bubq për 812 familje me vlerën 644,000 lekë.

a- Në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, të njoftohen tatimpaguesit familjarë me njoftim vlerësimi tatimor edhe në median lokale të Bashkisë për të paguar detyrimin tatimor. Njoftim Vlerësimet t’ju dërgohen nëpërmjet Zyrës Postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të paguara, si taksën e tokës, ndërtesës dhe tarifatat të tjera të pa paguara.

b - Zyra e taksave dhe tarifave vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të kryej rakordim me të gjitha subjektet që zhvillojnë në territorin e saj, aktivitet minerar dhe veçanërisht guroret, për përcaktimin e saktë të detyrimeve të pa paguara që kanë ndaj Bashkisë, si edhe ndaj ish komunave, lidhur me taksat dhe tarifatat vendore. Pas këtij rakordimi të hartoj listën përfundimtare të debitorëve për këto subjekte dhe të marrë masa për arkëtimin e tyre.

c-Të evidentohen subjektet që administrojnë tokë truall, sipërfaqen e miratuar për ndërtim dhe të parashikojë për këtë sipërfaqe aplikimin e taksës mbi truallin.

Menjëherë

12- Gjetjet nga auditimi: Në Bashkinë Krujë, NJA Fushë Krujë, Bubq dhe Nikël, kanë ushtruar aktivitet 127 subjekte të cilët nuk janë të regjistruar në QKR, duke sjellë mos arkëtimin e detyrimeve për taksat e tarifatat vendore në vlerën 9,569,368 lekë, që përbëjnë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë, veprime në papajtueshmëri me nenin 40 e 41, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 120-21, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1 - Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Krujë të marrë masa, të njoftojë zyrtarisht Drejtorinë Rajonale Tatimore duke kërkuar regjistrimin e 127 subjekteve në QKR dhe të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e detyrimeve në vlerën 9,569,368 lekë, të cilët kanë ushtruar aktivitet të pa licencuar sipas pasqyrës Aneks nr. 5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në vijimësi

13 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë, për pronat e transferuara nuk ka lidhur kontrata qiraje për objekte të cilat janë zaptuar nga persona të ndryshëm të cilët i përdorin për strehim apo për qëllime biznesi me sipërfaqe 10533.5 m², nga mos lidhja e kontratave të qirasë me këto persona llogariten të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 23,366,800 lekë, veprim në kundërshtim ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (*Trajtuar hollësisht në faqet 131-133, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1 - Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa, të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkatimin e vlerës 23,366,800 lekë, nga personat të cilët kanë zaptuar pronat e Bashkisë, sipas Aneksit nr. 6, 8, 9, 10, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

14 - Gjetje nga auditimi: Në ekonominë Pyjore të Bashkisë Krujë, kryejnë aktivitet për shfrytëzim karriere 15 subjekte, të cilët kanë në përdorim 627.73 ha sipërfaqe pyjore/kullosore të shfrytëzueshme. Këto subjekte nuk kanë lidhur kontratë për sipërfaqet që kanë në përdorim në vlerën 275,926 mijë lekë, duke krijuar mungesë të ardhurash me efekt negativ në buxhetet e Bashkisë, si dhe për këtë sipërfaqe nuk janë riklasifikuar në fond pyjor/kullosor, veprim në papajtueshmëri me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me pikën 6, neni 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullosor”, me pikat 3, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, ndryshuar dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”, të ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 134-136, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1 - Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa, të bëjë evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private duke i hequr nga fondi pyjorë dhe kullosorë, si dhe t'i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimin e veprimtarisë së kompanive minerare deri në lidhjen e kontratave për shfrytëzimin e sipërfaqes pyjore prej 627.725 ha, për arkëtimin qirasë në vlerën 275,926 mijë lekë, sipas Aneksit nr. 14, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në vijimësi

15 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë, nga 12 masa të lëna nga KLSH-ja në auditimin e mëparshëm, ka zbatuar 9 masa, në proces zbatimi 2 masa (masa nr. 1 e nr. 4), nuk ka zbatuar 1 masë (nr. 10), si dhe nuk ka arkëtuar vlerën 2,545,661 lekë, nga subjekti “A.” shpk në vlerën 1,677,661 lekë dhe “K. & C.” në vlerën 868,000 lekë, pasi ndodhen për shqyrtim në Gjykatën Administrative Tiranë, regjistruar me datë 28.04.2016. Nuk ka arkëtuar vlerën 507,300 lekë, nga subjekti “P.” shpk, nuk ka arkëtuar vlerën 600,000 lekë nga subjekti “A” sha dhe nuk ka arkëtuar vlerën 600,000 lekë, nga subjekti “VN” sha dhe detyrimi për taksën familjare në vlerën 286,200 lekë, veprim në papajtueshmëri me nenin 15 shkronja (j) dhe nenin 30 pika 2, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit” (*Trajtuar hollësisht në faqet 10, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

15.1 - Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa, të zbatojë rekomandimet e lëna nga KLSH-ja, si dhe të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e vlerës 1,993,500 lekë.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor në Bashkinë Krujë, nuk ka arkëtuar gjobat për shkeljet e konstatuara në ndërtimet pa leje ndërtimi, si dhe nuk ka ndjekur në rrugë ligjore me padi në gjykatë për 9 raste në vlerën 3,700,000 lekë, që përbëjnë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” nenet 20, 30 dhe ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 127-128, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

16.1 Rekomandimi: Bashkia Krujë, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor dhe Drejtoria Juridike të marrë masat dhe të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat për 9 vendime me gjobë për ndërtimet e kundërligjshme, të vendosura gjatë vitit 2015-2016 në vlerën 3,700,000 lekë, bazuar në nenet 151 dhe 152 të “Kodit Procedurës Civile në RSH”.

Njëherazi të marr masa për kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv në zbatim të nenit 24 -Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Menjëherë

17 - Gjetje nga auditimi: Bashkinë Krujë, në 9 investime me vlerë 32,658,263 lekë me tvsh nga dokumentacioni teknik i zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudit të punimeve të ndërtimit dhe nga verifikimi në terren, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën 3,963,445 lekë pa tvsh, veprim në kundërshtim me nenin 7 e 12, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” Kreu II, pika 3, 4 (*Trajtuar hollësisht në faqet 128-143, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17.1 - Rekomandim: Bashkia Krujë të merren masa, për monitorimin e vazhdueshëm të investimeve, si gjatë periudhës së zbatimit të punimeve ashtu edhe në përfundim të tyre. Dosjet teknike të objekteve të përfunduara të merren në dorëzim nga zyra e autorizuar sipas Rregullores së Brendshme të Bashkisë vetëm pas plotësimit të tyre.

Në vijimësi

18 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë, Drejtoria e Administrimit të Territorit, Aseteve, Pronave të Paluajtshme, nuk ka lidhur kontrata qiraje, për objektin: “Hoteli i Beqarëve” Fushë Krujë, pasi këshilli i Bashkisë me vendim nr. 108, datë 14.11.2014 ka vendosur nisjen e procedurave të privatizimit të objektit në emër të banorëve që jetojnë në këtë objekt, me sipërfaqe 716.84 m², me 21 apartamente. Nga mos lidhja e kontratave të qirasë për këto objekte, është shkaktuar mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë në vlerën 3,133,397 lekë, veprim në papajtueshmëri me nenin 2, të ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për Menaxhimin Financiarë dhe Kontrollin, të ndryshuar, pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, VKM nr. 529, datë 08.06.2011 i ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” dhe VKB nr. 108, datë 14.11.2014 “Për nisjen e procedurave të privatizimit të objektit “H. B.” (*Trajtuar hollësisht në faqet 126-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.1 - Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa, të lidhë kontratë qiraje me persona të cilët i përdorin apartamentet, si dhe të ndjek të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin nga 21 persona të vlerës 3,133,397 lekë (sipas Aneksit nr. 8, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19. Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë edhe pse ka mazhorancën e aksioneve në Ujësjetllës sh.a Krujë, nuk e ka përcaktuar si agjent tatimor nëpërmjet një marrëveshje, për të arkëtuar detyrimet për taksat dhe tarifave vendore për 4474 familje, në vlerën 3,096,000 lekë, së bashku me faturat e ujit të pijshëm, bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5 shkronja (ii), neni 7 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar, pikës 7.1 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar, marrëveshje e cila do të rriste arkëtimin e taksave vendore dhe do rigjenerojë të ardhura për Bashkinë Krujë (*Trajtuar hollësisht në faqet 118-119, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19.1 Rekomandimi: Bashkia Krujë të përgatisë aktmarrëveshjen me Ujësjetllës sh.a. Krujë, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore të popullatës për 4474 familje në vlerën 3,096,000 lekë, së bashku me faturat e ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak bazuar në legjislacionin në fuqi.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i Njësisë Publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **12,339,075 lekë**, si më poshtë:

1 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë me urdhër shpenzim nr. 128, datë 30.03.2015, në shumën 80,000 lekë, për gratë e Bashkisë ka organizuar drekë me rastin e festës së 8 Marsit, ndërsa shpenzimet e kryera në vlerën 80,000 lekë, përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me pika 9, të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar me VKM nr. 826, datë 05.12.2011, VKM nr. 849, datë 06.12.2012, pikën 1/b, të VKM nr. 472, datë 2.7.2011 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore” (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën C. 1 faqen 25-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 - Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e pagesave të kryera për festën e 8 marsit në vlerën **80,000 lekë**.

Brenda muajt Janar 2018

2 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë me urdhër shpenzim nr. 138, datë 03.04.2015, në shumën 298,000 lekë, anëtarët e këshillit të Bashkisë Krujë ka zhvilluar udhëtim turistike në Sofje, Bullgari. Bashkëlidhur urdhër shpenzimit nuk ndodhen: programi i hartuar nga këshilli i Bashkisë, qëllimi i udhëtimit, data, preventivi i shpenzimeve, faturat tatimore për fjetje në hotel, etj. Anëtarët e këshillit të bashkisë nuk mund të shkojnë për udhëtim turistik, ndërsa shuma 298,000 lekë, përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Krujë, veprim në papajtueshmëri me germa a pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar” (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën C. 1 faqen 26-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 - Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin nga **17 anëtarët** e këshillit të Bashkisë Krujë të cilët janë paguar për në udhëtim turistike në Sofje, Bullgari në vlerën **298,800 lekë**.

Brenda muajt Janar 2018

3 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë me urdhër shpenzim nr. 552, datë 24.06.2015, në shumën 18,000 lekë ka blerë kafe me kapsula. Institucionet shtetërore apo vendore mund të kryej shpenzime për pritje dhe përcjellje, por duke hartuar program pritje për delegacioni, qëllimin i takimit të delegacionit, numri i pjesëmarrësve, kuota e shpenzimit sipas grupeve etj. Preventivi i shpenzimeve për pritje delegacioni miratohet nga titullari i institucionit, ndërsa shuma 18,000 lekë, përbënë shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me germa a pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, me pikën 42, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 243, datë

15.05.1995 “Për shpenzimet për pritjen, përcjelljen dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, të ndryshuar, (Trajtuar hollësisht në faqet 27-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 - Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin nga 2 persona sa paguar padrejtësisht për pritje përcjellje nga fondet e buxhetit të Bashkisë Krujë në vlerën **18,000 lekë**, përkatësisht:

- në vlerën 9,000 lekë, nga Sh. H. me detyrë ish-Kryetar Bashkie;

- në vlerën 9,000 lekë, R. S., me detyrë ish-Përgjegjëse e Sektorit të Financës.

Brenda muajt Janar 2018

4 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë me urdhër shpenzim nr. 1804, datë 29.12.2015, në rastin e festës së Ullirit ka organizuar një drekë me 60 persona pjesëmarrës duke shpenzuar shumën 108,000 lekë, e cila përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Krujë, pagesa në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, i ndryshuar me VKM nr. 258 datë 3.6.1999 (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën C. 1 faqen 29-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 - Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin nga 60 punonjës të Bashkisë Krujë të vlerës **108,000 lekë**.

Brenda muajt Janar 2018

5 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë me urdhër shpenzim nr. 527, datë 18.03.2016, në shumën 168,300 lekë, nr. 528, datë 18.03.2016, në shumën 15,300 lekë, nr. 529, datë 18.03.2016, në shumën 45,900 lekë, për pjesëmarrje në koncertin Kombëtar të Këngës Popullore, organizuar në qytetin e Elbasanit datë 11-12.03.2016.

Ministria e Kulturës, Qendra Kombëtare e Veprimtarive folklorike Tiranë, me shkresë nr. 25/9, datë 25.01.2016, ka përcaktuar: “Grupet do të paraqiten në konkurrim me një program me gjatësi deri në 15 minuta dhe me numër pjesëmarrësish jo më shumë se 12 persona, artistë dhe staf mbështetës.”. Shpenzimet për fjetje dhe ushqim janë përballuar nga pala pritëse, ndërsa Bashkia Krujë duhet të përballonte vetëm shpenzim e transportit. Drejtoria e Financës, ka paguar 15 persona më shumë 221,400 lekë, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Krujë, veprim në papajtueshmëri me nenin 12 pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe VKM nr. 1173, datë 06.11.2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura” (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën C. 1 faqen 31-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 - Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin nga 15 persona të vlerës **221,400 lekë**, sa paguar pa u mbështetur në dispozitë ligjore, për pjesëmarrje në koncertin Kombëtar të Këngës Popullore organizuar në qytetin e Elbasanit datë 11-12.03.2016.

Brenda muajt Janar 2018

6 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë me urdhër shpenzim nr. 1682, datë 26.08.2016, në shumën 550,000 lekë, ka paguar udhëtim e dieta personelin e Repartit ushtarak nr. 4040, Komanda Mbështetëse, Ministria Mbrojtjes Tiranë. Dhënia e dietave të plota dhe e shpenzimeve të fjetjes për punonjësit e Repartit Ushtarak nr. 4040 Tiranë, në shumën 550,000 lekë, përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me pikën I, të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”, të ndryshuar (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën C. 1 faqen 32-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 - Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin nga 10 persona të vlerës **550,000 lekë**, sa paguar pa

mbështetur në dispozitë ligjore për udhëtim e dieta personelin e Repartit ushtarak nr. 4040, Komanda Mbështetëse, Ministria Mbrojtjes Tiranë.

Brenda muajt Janar 2018

7- Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë ka kryer pagesa për shpërblimin e anëtarëve të këshillit të bashkisë të cilët, kanë munguar në mbledhjet e këshillit, duke u shpërblyer edhe për muajt në të cilët nuk janë zhvilluar mbledhjet e këshillit të bashkisë, për vitin 2015, që përbën dëmin ekonomik në vlerën 1,102,461 lekë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, Kreu VI, neni 29, pika 2 dhe ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 31, pika 2 dhe 8 (*Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën C. 1 faqen 23-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1- Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin nga 45 persona te vlerës **1,102,461 lekë**, të cilët kanë munguar në mbledhjet e këshillit për vitin 2015, ndërkohë janë shpërblyer (paguar) edhe për muajt në të cilët nuk janë zhvilluar mbledhjet e këshillit të bashkisë.

Brenda muajt Janar 2018

8 - Gjetje nga auditimi: Për vitin 2015, vitin 2016 i janë xhiruar më tepër shuma 264, 000 lekë, Klubit Futbollit “I.” qyteti Fushë-Krujë. shumë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin KF Iliria, në kundërshtim me ligjin vendos nenin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe Kontratës së Qirasë nr. 337 Rep, nr. 189 Kol, datë 22.01.2016 neni 4 (*Trajtuar hollësisht në faqet 13-14, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1 - Rekomandim: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me sektorin juridik të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **264,000 lekë**, përfutuar padrejtësisht nga K- F “I.” sha, qyteti Fushë-Krujë.

Brenda muajt Janar 2018

9 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë, në objektin: “Sistemimi asfaltim i rrugëve qendër Dukagjin i Ri Thumanë” Krujë, nga i dokumentacioni teknik i zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën 76,106 lekë pa tvsh, veprim në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5008, datë 25.11.2016, lidhur ndërmjet Bashkisë Krujë dhe BOE “M.” shpk dhe “V.. E” shpk, kontratën e mbikëqyrjes së punimeve nr. 5042, datë 25.11.2016 dhe kontratën e kolaudimit të punimeve nr. 1627, datë 16.03.2016 (*Trajtuar hollësisht në faqet 105-106, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1 - Rekomandim: Bashkia Krujë të merren masa, të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e vlerës **76,106 lekë pa tvsh** për punimeve të pakryera, nga bashkimi i operatorëve ekonomik BOE “M.” shpk dhe “V. E” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 5008, datë 25.11.2016 me objekt: “Sistemimi asfaltim i rrugëve qendër Dukagjin i Ri Thumanë” Krujë.

Menjëherë

10 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë, në objektin: “Sistemimi asfaltim i rrugës SMT-së dhe sistemimi i ujërave të sheshit pranë poliklinikës Fushë Krujë” Krujë, nga dokumentacioni teknik i zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën 41,920 lekë pa tvsh, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2019, datë 24.08.2015, lidhur ndërmjet ish-Bashkisë Fushë Krujë dhe OE “D. G” shpk, me kontratën e mbikëqyrjes së punimeve nr. 134, datë 23.06.2013, me kontratën e kolaudimit të punimeve pa numër datë 30.06.2015 (*Trajtuar hollësisht në faqet 107-108, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1 - Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa, të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e vlerës **41,920 lekë pa tvsh** për punime të pakryera nga “D.G” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2019, datë 24.08.2015 me objekt: “Sistemimi asfaltim i rrugës SMT - së dhe sistemimi i ujërave të sheshit pranë poliklinikës Fushë Krujë” Krujë.

Menjëherë

11 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë, në objektin: “Sistemimi asfaltim i rrugës nr. 2 pranë unazës së vogël, Fshati Fushë Krujë” Krujë, nga dokumentacioni teknik i zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën 14,780 lekë pa tvsh, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1657, datë 25.05.2015, lidhur ndërmjet Bashkisë Fushë Krujë dhe OE “M.” shpk dhe kontratën e kolaudimit të punimeve nr. 139, datë 22.06.2015 (*Trajtuar hollësisht në faqet 109-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1 - Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa, të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e vlerës **14,780 lekë pa tvsh** nga OE “M.” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën pa numër datë 15.06.2015 me objekt: “Sistemimi asfaltim i rrugës nr. 2 pranë unazës së vogël, Fshati Fushë Krujë” Krujë, për punime të pakryera.

Menjëherë

12 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë, në objektin: “Pastrim i shtratit të lumit Zezë” Krujë, nga dokumentacioni teknik i zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën 160,000 lekë pa tvsh, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3661, datë 30.08.2016, të lidhur ndërmjet Bashkisë Krujë dhe OE “H.” shpk dhe kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes nr. 3671, datë 30.08.2016 (*Trajtuar hollësisht në faqet 113-114, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1 - Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa, të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e vlerës **160,000 lekë pa tvsh** për punime të pakryera nga OE “H.” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 3661, datë 30.08.2016 me objekt: “Pastrim i shtratit të lumit Zezë” Krujë.

Menjëherë

13 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë, në objektin: “Sistemimi i segmentit të rrugës Bubq” Krujë, nga dokumentacioni teknik i zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën 200,277 lekë pa tvsh, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1585, datë 30.12.2013, lidhur ndërmjet Komunës Bubq dhe OE “A” shpk dhe kontratës shërbimit të mbikëqyrjes nr. 3671, datë 30.08.2016 (*Trajtuar hollësisht në faqet 116-117, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1 - Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa, të ndjek në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e vlerës **200,277 lekë pa tvsh** për punime të pakryera, nga OE “A” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 1585, datë 30.12.2013 me objekt: “Sistemimi i segmentit të rrugës Bubq” Krujë.

Menjëherë

14 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë, në objektin: “Rikonstruksion i rrugëve, Rruga nga dy segmentshi-baseni i liqenit Tarin; Shkolla Tari-Lagje e Shoteve, Bubq” Krujë, nga dokumentacioni teknik i zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën 546,623 lekë pa tvsh, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1585, datë 30.12.2013, lidhur ndërmjet Komunës Bubq dhe OE “A.A.” shpk dhe kontratës shërbimit të mbikëqyrjes nr. 1538/1, datë 13.12.2013 (*Trajtuar hollësisht në faqet 117-1118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1 - Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa, të ndjek në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e vlerës **546,623 lekë pa tvsh** për punime të pakryera nga OE “A.A.” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 1585, datë 30.12.2013 me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve, Rruga nga dy segmenti shi-baseni i liqenit Tarin; Shkolla Tari-Lagje e Shoteve, Bubq” Krujë.

Menjëherë

15 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë, me subjektin “F.K. C.F.” sha, ka lidhur kontratë nr. 407, datë 21.01.2011, me afat 10 vjeçare, për përdorim të një sipërfaqe 3.5235 ha, për prodhimin e inerteve çakull dhe gurë gëlqeror, vlera e qirasë është në shumën 1,442,918 lekë/vit e cila është

llogaritur sipas VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të Kullotave”, të ndryshuar. Subjekti “F. K. C. F.” sha për 6 vitet 2012, 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 2017 nuk ka likuiduar detyrimet gjithsej në vlerën 8,657,508 lekë, që përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Krujë, veprim në kundërshtim me kushtet e Kontratës nr. 156/1, datë 20.04.2007 (*Trajtuar hollësisht në faqet 131-131, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

15.1 - Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për të kërkuar zbatimin e kontratës nr. 407, datë 21.01.2011 dhe arkëtimin e vlerës **8,657,508 lekë**, nga subjekti “F.K. C. F.”sha.

Menjëherë

C. 2. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë, në 8 procedura prokurimi me vlerë **33,676,934 lekë** (me tvsh), ka mos përmbushje të rregullave në procedurat e prokurimit, për mos përdorim me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet të fondeve publike, veprime në kundërshtim me nenin 1, 2, 24, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe kreu V, pika 1/a, pika 4/h, të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqen 48-104, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 - Rekomandimi: Bashkia Krujë, të marrë masa, të eliminojë praktikatat që çojnë në efektivitet të ulët të prokurimeve për mallra e shërbime, për të ardhmen, gjatë planifikimit të fondeve për mallra dhe shërbime procedurat e tenderit të jenë në përputhje me fondet e planifikuara.

Në vijimësi

D. MASA ADMINISTRATIVE

D. 1. Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin e KM nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr.183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë**, Kryetarit të Bashkisë Krujë t'i **kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative me gjobë**, për **3 mbikëqyrës punimesh**, si më poshtë:

1 – T. S. në shumën 50,000 lekë, për shkeljet e konstatuara në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin: “Sistemimi asfaltim i rrugëve qendër Dukagjin i Ri Thumanë”, me sipërmarrës punimesh OE “V.& M.” shpk, për diferencat për volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën 76,106 lekë pa tvsh, në kundërshtim me nenin 7 e 12, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” Kreu II, pika 3.

2 – R. Ll. në shumën 50,000 lekë, për shkeljet e konstatuara në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin “Sistemimi asfaltim i rrugës SMT - së dhe sistemimi i ujërave të sheshit pranë poliklinikës Fushë Krujë”, me sipërmarrës punimesh OE “D. G” shpk, për diferencat për

volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën 41,920 lekë pa tvsh, në kundërshtim me nenin 7 e 12, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” Kreu II, pika 3.

3 – L. K. në shumën 50,000 lekë, për shkeljet e konstatuara nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin “Sistemimi i segmentit të rrugës Bubq”, me sipërmarrës punimesh OE “H.” shpk, për diferencat për volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën 200,277 lekë pa tvsh, në kundërshtim me nenin 7 e 12, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” Kreu II, pika 3.

D. 2. Për Agjencinë e prokurimit publik.

I. Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve me vlerë të lartë për periudhën 01.01.2015 deri më 30.09.2017, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin e Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), ndaj **8 punonjësve për 6 procedura prokurimi**, si më poshtë:

1 – A. D., me detyrë Drejtoreshë e Drejtorisë së Projektimit Kontrollit dhe Zhvillimit Territorit, në cilësinë e anëtares së NJHDT;

2 – G.H., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të NJHDT;

3 – E. C., me detyrë Specialiste e Prokurimeve, në cilësinë e anëtares së NJHDT;

4 – S. S. me detyrë Specialiste e Prokurimeve, në cilësinë e anëtares së KVO;

5 – F.C., me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, në cilësinë e kryetarit të KVO;

6 – I.H., me detyrë Specialiste e Drejtorisë Juridike, në cilësinë e anëtares së KVO;

7- R.B., me detyrë Drejtor i Shërbimeve Publike, në cilësinë e anëtarit të KVO;

8 – E. S., me detyrë Specialist i Drejtorisë së Projektimit Kontrollit dhe Zhvillimit Territorit, në cilësinë e antarit të KVO;

E konkretisht nga auditimi i këtyre procedurave rezultuan mangësi të përbashkëta sa vijon:

1 – A. D., me detyrë Drejtoreshë e Drejtorisë së Projektimit Kontrollit dhe Zhvillimit Territorit, në cilësinë e anëtares së NJHDT;

- Në tenderin me objekt: “Rikonstruksion i Godinës së Bashkisë Krujë”, me fond limit 54,514,868 lekë, zhvilluar në vitin 2016, pasi kriteret e përdorura nuk janë të lidhura me objektin e kontratës, nga Bashkia Krujë është kërkuar në mënyrë të paargumentuar vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve dhe është kërkuar që OE të ketë në përbërje të stafit të paketën 1 punonjës i pajisur me dëshmi për ushtrimin e profesionit të zjarrmëtarit, në kundërshtim me nenin 1, 2, 46 pika 1 e 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe me VKM 914, neni 61 pika 2 paragrafi 2.

- Në tenderin me objekt: “Zgjerim i Rrugës Kryesore si dhe Rikualifikimi i Sheshit Mustafa Merlika”, me fond limit 94,154,018 lekë, zhvilluar në vitin 2017, pasi kriteret e përdorura nuk janë të lidhura me objektin e kontratës, numri fuqisë punëtore mesatarisht 90 punonjës është i paargumentuar, në kundërshtim me nenin 1, 2, 46, pika 1 e 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 61 pika 2 paragrafi 2, të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit”.

- Në tenderin me objekt: “Sistemim-asfaltim i rrugës Arrameras Kullas Fushë Kruje”, me fond limit 21,067,438 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se kriteret e përdorura nuk janë të

lidhura ngushtë me objektin e kontratës, është kërkuar në mënyrë të paargumentuar vërtetimi nga Bashkia Krujë për shlyerjen e detyrimeve, janë kërkuar nivelet të larta të licencës profesionale të shoqërisë, është kërkuar numri i fuqisë punëtore mesatarisht 50 punonjës, janë kërkuar padrejtësisht FDP, në kundërshtim me nenin 1, 2, 46 pika 1 e 3, të LPP të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar nenin 61 pika 2 paragrafi 2, të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit”.

- Në tenderin me objekt: “Sistemim-asfaltim rruga Sadik Petrela, Përroi i bardhë Nikel”, me fond limit 20,252,598 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se kriteret e përdorura nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, është kërkuar në mënyrë të paargumentuar vërtetimi nga Bashkia Krujë për shlyerjen e detyrimeve, janë kërkuar nivelet të larta të licencës profesionale të shoqërisë, është kërkuar numri i fuqisë punëtore i mesatarisht 50 punonjës, janë kërkuar padrejtësisht FDP, në kundërshtim me nenin 1, 2, 46 pika 1 e 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 61 pika 2 paragrafi 2, të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit”.

- Në tenderin me objekt: “Zgjerim i rrugës hyrëse të qytetit, parkimi dhe rikualifikim i qendrës së qytetit Krujë”, me fond limit 305,234,892 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se kriteret e përdorura nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, është kërkuar në mënyrë të paargumentuar vërtetimi nga Bashkia Krujë për shlyerjen e detyrimeve, janë kërkuar nivelet të larta të licencës profesionale të shoqërisë, është kërkuar numri i fuqisë punëtore mesatarisht 150 punonjës, është kërkuar që OE te ketë ne përbërje te stafit te paketën 1 punonjës qe te jete i pajisur me dëshmi për ushtrimin e profesionit të zjarrmëtarit, në kundërshtim me nenin 1, 2, 46 pika 1 e 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 61 pika 2 paragrafi 2, të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit”.

2 – G. H., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të NJHDT;

- Në tenderin me objekt: “Rikonstruksion i Godinës së Bashkisë Krujë”, me fond limit 54,514,868 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se kriteret e përdorura nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, është kërkuar në mënyrë të paargumentuar vërtetimi nga Bashkia Krujë për shlyerjen e detyrimeve, është kërkuar numri i fuqisë punëtore mesatarisht 50 punonjës, është kërkuar që OE te ketë ne përbërje te stafit te paktën 1 punonjës qe te jete i pajisur me dëshmi për ushtrimin e profesionit të zjarrmëtarit, në kundërshtim me nenin 1, 2, 46 pika 1 e 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 61 pika 2 paragrafi 2, të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit”.

- Në tenderin me objekt: “Zgjerim i Rrugës Kryesore si dhe Rikualifikimi i Sheshit Mustafa Merlika”, me fond limit 94,154,018 lekë, zhvilluar në vitin 2017, u konstatua se kriteret e përdorura nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, është kërkuar numri i fuqisë punëtore mesatarisht 90 punonjës, është kërkuar në mënyrë të paargumentuar një numër i madh makinerish dhe inxhinierësh, në kundërshtim me nenin 1, 2, 46 pika 1 e 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 61 pika 2 paragrafi 2, të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit”.

- Në tenderin me objekt: “Sistemim-asfaltim i rrugës Arrameras Kullas Fushë Kruje”, me fond limit 21,067,438 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se kriteret e përdorura nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, është kërkuar në mënyrë të paargumentuar vërtetimi nga Bashkia Krujë për shlyerjen e detyrimeve, janë kërkuar nivelet të larta të licencës profesionale të shoqërisë, është kërkuar numri i fuqisë punëtore mesatarisht 50 punonjës, janë kërkuar padrejtësisht FDP, në kundërshtim me nenin 1, 2, 46 pika 1 e 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 61 pika 2 paragrafi 2, të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit”.

-Në tenderin me objekt: “Sistemim-asfaltim rruga Sadik Petrela, Përroi i bardhë Nikel”, me fond limit 20,252,598 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se kriteret e përdorura nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, është kërkuar në mënyrë të paargumentuar vërtetimi nga Bashkia Krujë për shlyerjen e detyrimeve, janë kërkuar nivelet të larta të licencës profesionale të shoqërisë, është kërkuar numri i fuqisë punëtore mesatarisht 50 punonjës, janë kërkuar padrejtësisht FDP, në kundërshtim me nenin 1, 2, 46 pika 1 e 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006

“Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 61 pika 2 paragrafi 2, të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit”.

- Në tenderin me objekt: “Zgjerim i rrugës hyrëse të qytetit, parkimi dhe rikualifikim i qendrës së qytetit Krujë”, me fond limit 305,234,892 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se kriteret e përdorura nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, është kërkuar në mënyrë të paargumentuar vërtetimi nga Bashkia Krujë për shlyerjen e detyrimeve, janë kërkuar nivelet të larta të licencës profesionale të shoqërisë, është kërkuar numri i fuqisë punëtore mesatarisht 150 punonjës, është kërkuar që OE të ketë ne përbërje te stafit te paketën 1 punonjës qe te jete i pajisur me dëshmi për ushtrimin e profesionit të zjarrmëtarit, në kundërshtim me nenin 1, 2, 46 pika 1 e 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 61 pika 2 paragrafi 2, të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit”.

3 – E. C., me detyrë Specialiste e Prokurimeve, në cilësinë e anëtares së NJHDT;

- Në tenderin me objekt: “Rikonstruksion i Godinës së Bashkisë Krujë”, me fond limit 54,514,868 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se kriteret e përdorura nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, është kërkuar në mënyrë të paargumentuar vërtetimi nga Bashkia Krujë për shlyerjen e detyrimeve, është kërkuar numri i fuqisë punëtore i mesatarisht 50 punonjës, është kërkuar që OE të ketë në përbërje te stafit të paketën 1 punonjës qe te jete i pajisur me dëshmi për ushtrimin e profesionit të zjarrmëtarit, në kundërshtim me nenin 1, 2, 46 pika 1 e 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 61 pika 2 paragrafi 2, të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit”.

- Në tenderin me objekt: “Zgjerim i Rrugës Kryesore si dhe Rikualifikimi i Sheshit Mustafa Merlika”, me fond limit 94,154,018 lekë, zhvilluar në vitin 2017, u konstatua se kriteret e përdorura nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, është kërkuar numri i fuqisë punëtore i mesatarisht 90 punonjës, është kërkuar në mënyrë të paargumentuar një numër i madh makinerish dhe inxhinieresh, në kundërshtim me nenin 1, 2, 46 pika 1 e 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 61 pika 2 paragrafi 2, të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit”.

- Në tenderin me objekt: “Sistemim-asfaltim i rrugës Arrameras Kullas Fushë Krujë”, me fond limit 21,067,438 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se kriteret e përdorura nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, është kërkuar në mënyrë të paargumentuar vërtetimi nga Bashkia Krujë për shlyerjen e detyrimeve, janë kërkuar nivelet të larta të licencës profesionale të shoqërisë, është kërkuar numri i fuqisë punëtore mesatarisht 50 punonjës, janë kërkuar padrejtësisht FDP, në kundërshtim me nenin 1, 2, 46 pika 1 e 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 61 pika 2 paragrafi 2, të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit”.

- Në tenderin me objekt: “Sistemim-asfaltim rruga Sadik Petrela, Përroi i bardhë Nikël”, me fond limit 20,252,598 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se kriteret e përdorura nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, është kërkuar në mënyrë të paargumentuar vërtetimi nga Bashkia Krujë për shlyerjen e detyrimeve, janë kërkuar nivelet të larta të licencës profesionale të shoqërisë, është kërkuar numri i fuqisë punëtore mesatarisht 50 punonjës, janë kërkuar padrejtësisht FDP, në kundërshtim me nenin 1, 2, 46 pika 1 e 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 61 pika 2 paragrafi 2, të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit”.

- Në tenderin me objekt: “Zgjerim i rrugës hyrëse të qytetit, parkimi dhe rikualifikim i qendrës së qytetit Krujë”, me fond limit 305,234,892 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se kriteret e përdorura nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, është kërkuar në mënyrë të paargumentuar vërtetimi nga Bashkia Krujë për shlyerjen e detyrimeve, janë kërkuar nivelet të larta të licencës profesionale të shoqërisë, është kërkuar numri i fuqisë punëtore mesatarisht 150 punonjës, është kërkuar që OE të ketë në përbërje të stafit te paketën 1 punonjës qe te jete i pajisur me dëshmi për ushtrimin e profesionit të zjarrmëtarit, në kundërshtim me nenin 1, 2, 46 pika 1 e 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 61 pika 2 paragrafi 2, të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit”.

4 – S. S., me detyrë Specialiste e Prokurimeve, në cilësinë e anëtares së KVO;

- Në tenderin me objekt: “Rikonstruksion i Godinës së Bashkisë Krujë”, me fond limit 54,514,868 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se kriteret e përdorura nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, është kërkuar në mënyrë të paargumentuar vërtetimi nga Bashkia Krujë për shlyerjen e detyrimeve, është kërkuar numri i fuqisë punëtore i mesatarisht 50 punonjës, është kërkuar që OE te ketë në përbërje të stafit të paketën 1 punonjës që te jete i pajisur me dëshmi për ushtrimin e profesionit të zjarrmëtarit, në kundërshtim me nenin 1, 2, 46 pika 1 e 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 61 pika 2 paragrafi 2, të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit”.

- Në tenderin me objekt: “Zgjerim i Rugës Kryesore si dhe Rikualifikimi i Sheshit Mustafa Merlika”, me fond limit 94,154,018 lekë, zhvilluar në vitin 2017, u konstatua se kriteret e përdorura nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, është kërkuar numri i fuqisë punëtore i mesatarisht 90 punonjës, është kërkuar në mënyrë të paargumentuar një numër i madh makinerish dhe inxhinieresh, në kundërshtim me nenin 1, 2, 46 pika 1 e 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 61 pika 2 paragrafi 2, të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit”.

- Në tenderin me objekt: “Sistemim-asfaltim i rrugës Arrameras Kullas Fushë Kruje”, me fond limit 21,067,438 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se kriteret e përdorura nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, është kërkuar në mënyrë të paargumentuar vërtetimi nga Bashkia Krujë për shlyerjen e detyrimeve, janë kërkuar nivelet të larta të licencës profesionale të shoqërisë, është kërkuar numri i fuqisë punëtore mesatarisht 50 punonjës, janë kërkuar padrejtësisht FDP, në kundërshtim me nenin 1, 2, 46 pika 1 e 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 61 pika 2 paragrafi 2, të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit”.

- Në tenderin me objekt: “Sistemim-asfaltim rruga Sadik Petrela, Përroi i bardhë Nikel”, me fond limit 20,252,598 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se kriteret e përdorura nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, është kërkuar në mënyrë të paargumentuar vërtetimi nga Bashkia Krujë për shlyerjen e detyrimeve, janë kërkuar nivelet të larta të licencës profesionale të shoqërisë, është kërkuar numri i fuqisë punëtore mesatarisht 50 punonjës janë kërkuar padrejtësisht FDP, në kundërshtim me nenin 1, 2, 46 pika 1 e 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 61 pika 2 paragrafi 2, të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit”.

5 – F.C., me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, në cilësinë e kryetarit të KVO;

- Në tenderin me objekt: “Rehabilitim i skemës ujitëse te rezervuarit Thumane”, me fond limit 25,833,275 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “B.” shpk, pasi nuk ka plotësuar kërkesat e DST, në kundërshtim me neni 1, 2, 24 dhe 46, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

- Në tenderin me objekt: “Zgjerim i Rugës Kryesore si dhe Rikualifikimi i Sheshit Mustafa Merlika”, me fond limit 94,154,018 lekë, zhvilluar në vitin 2017, u konstatua se asnjë nga OE ekonomik nuk ka plotësuar kriteret e kualifikimit, duke shpallur padrejtësisht fitues OE “B.” shpk, në kundërshtim me nenin 46 dhe 53 pika 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

- Në tenderin me objekt: “Rikonstruksion i Godinës së Bashkisë Krujë”, me fond limit 54,514,868 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “H.” shpk, pasi nuk ka plotësuar kërkesat e DST, në kundërshtim me nenin 46 dhe 53 pika 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

- Në tenderin me objekt: “Zgjerim i rrugës hyrëse të qytetit, parkimi dhe rikualifikim i qendrës së qytetit Krujë”, me fond limit 305,234,892 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se KVO duhej të kishte anuluar procedurën e prokurimi pasi asnjë nga OE pjesëmarrës nuk ka plotësuar kriteret për kualifikim, në kundërshtim me nenin 46 dhe 53 pika 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

6 – I.H., me detyrë Specialiste e Drejtorisë Juridike, në cilësinë e anëtares së KVO;

- Në tenderin me objekt: “Rehabilitim i skemës ujitëse te rezervuarit Thumane”, me fond limit 25,833,275 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe

shpallur fitues OE "B." shpk, pasi nuk ka plotësuar kërkesat e DST, në kundërshtim me neni 1, 2, 24 dhe 46, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

- Në tenderin me objekt: "Zgjerim i Rrugës Kryesore si dhe Rikualifikimi i Sheshit Mustafa Merlika", me fond limit 94,154,018 lekë, zhvilluar në vitin 2017, u konstatua se tenderi pasi asnjë nga OE ekonomik nuk ka plotësuar kriteret e kualifikimit, duke kualifikuar dhe shpallur padrejtësisht fitues OE "B." shpk, në kundërshtim me nenin 46 dhe 53 pika 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

- Në tenderin me objekt: "Rikonstruksion i Godinës së Bashkisë Krujë", me fond limit 54,514,868 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE "H." shpk, pasi nuk ka plotësuar kërkesat e DST, në kundërshtim me nenin 46 dhe 53 pika 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

- Në tenderin me objekt: "Zgjerim i rrugës hyrëse të qytetit, parkimi dhe rikualifikim i qendrës së qytetit Krujë", me fond limit 305,234,892 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se asnjë nga OE nuk ka plotësuar kriteret për kualifikim, në kundërshtim me nenin 46 dhe 53 pika 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

7 – R. B., me detyrë Drejtor i Shërbimeve Publike, në cilësinë e anëtarit të KVO;

- Në tenderin me objekt: "Zgjerim i rrugës hyrëse të qytetit, parkimi dhe rikualifikim i qendrës së qytetit Krujë", me fond limit 305,234,892 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se asnjë nga OE pjesëmarrës nuk ka plotësuar kriteret për kualifikim, në kundërshtim me nenin 46 dhe 53 pika 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

- Në tenderin me objekt: "Rehabilitim i skemës ujitëse te rezervuarit Thumane", me fond limit 25,833,275 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE "B." shpk, pasi nuk ka plotësuar kërkesat e DST, në kundërshtim me nenin 1, 2, 24 dhe 46, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

8 – E.S., me detyrë Specialist i Drejtorisë së Projektimit Kontrollit dhe Zhvillimit Territorit, në cilësinë e anëtarit të KVO;

- Në tenderin me objekt: "Zgjerim i Rrugës Kryesore si dhe Rikualifikimi i Sheshit Mustafa Merlika", me fond limit 94,154,018 lekë, zhvilluar në vitin 2017, u konstatua se asnjë nga OE ekonomik nuk ka plotësuar kriteret e kualifikimit, duke kualifikuar dhe shpallur padrejtësisht fitues OE "B." shpk, në kundërshtim me kërkesat e nenit 46 dhe 53 pika 3.

- Në tenderin me objekt: "Rikonstruksion i Godinës së Bashkisë Krujë", me fond limit 54,514,868 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE "H." shpk, pasi nuk ka plotësuar kërkesat e DST, në kundërshtim me nenin 46 dhe 53 pika 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

E. MASA DISIPLINORE:

E. 1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të nenit 58, shkronja (a) "llojet e masave disiplinore" të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2017 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar me **ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014**, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil" dhe nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Krujë, që ti kërkojë Komisionit disiplinor të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore **13 punonjësve** të mëposhtëm:

1 – Xh. Xh., me detyrë Drejtore e Financës nga data 01.10.2015 e në vazhdim, pasi:

- Për pagesatë e kryera për pjesëmarrëjen në koncertin e organizuar në Elbasan duke paguar 229,500 lekë, në kundërshtim me nenin 12 pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të ndryshuar".

- Për pagesën e dietave të plota dhe e shpenzimeve të fjetjes për punonjësit e Repartit Ushtarak nr. 4040 Tiranë, në shumën 550,000 lekë, përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me pikën I, të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”, të ndryshuar.

- Në 5 raste për pagesën e kryer në lidhje me ndarjet kulturore të organizuar nga Bashkia Krujë, në kundërshtim me nenin 12 pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe VKM nr. 1173, datë 06.11.2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura”.

- Për mos bërjen hyrje të studimeve dhe projekteve sipas Bilancit kontabël, kundërshtim me shkronjën f neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

- Për mos arkëtimin e debitorëve të ndryshëm, në kundërshtim me germa g neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar (*Trajtuar në faqet 27-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2 – R. S., me detyrë ish-Përgjegjëse e Sektorit Ekonomik, deri me datë 01.01.2015, aktualisht Përgjegjëse e Sektorit të Financës, pasi:

- Ka kryer pagesën në shumën 80,000 lekë, me rastin e festës së 8 Marsit për punonjësit e Bashkisë, në kundërshtim me VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” pika 9 të ndryshuar dhe pikën 1/b, të VKM nr. 472, datë 2.7.2011 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”.

- Për kryerjen e pagesës së anëtarë të këshillit të Bashkisë në shumën 298,000 lekë për udhëtim turistik në Sofie, Bullgari, në kundërshtim me germa a pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar”.

- Për mos bërjen hyrje të 25 copë tavolina me vlerë 148,750 lekë, me konstruksion hekuri të veshura me llamarinë për tregun e qyteti, në kundërshtim me germa a pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, me pikën 42, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar dhe germa a pika 1 kreu VI, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimeve publike”, të ndryshuar.

- Për pagesën për shpenzime pritje përcjellje në shumën 18,000 lekë, në kundërshtim me germa a pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, me pikën 42, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për shpenzimet për pritjen, përcjelljen dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, të ndryshuar.

- Në 2 raste për pagesën e kryer në lidhje me ngjarjet kulturore të organizuar nga Bashkia Krujë, në kundërshtim me nenin 12 pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe VKM nr. 1173, datë 06.11.2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura” (*Trajtuar në faqet 21-25, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3 – E. S. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit Juridik, pasi:

- Për pagesën e kryer në shumën 108,000 lekë, me rastin e festës së “Ullirit”, në kundërshtim me pikën 1/b, të VKM nr. 472, datë 2.7.2011 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”.

- Për pagesën e kryer për vendimet e Gjykatës së Apelit, pa bërë Rekurs në Gjykatën e Lartë Kolegjiv Administrativ, në kundërshtim me nenin 12 pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

- Për largimin nga puna të punonjësve me Status të Shërbimit Civil dhe Kontratë Pune, në kundërshtim me pikën 42, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar (*Trajtuar në faqet 25-29, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4 – F. S., me detyrë specialiste finance, pasi:

- Në funksionin e kryetarit të komisionit të inventarizimit para fillimit të inventarit **nuk ka mbajtur** një procesverbal midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit për të fiksuar numri rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes së magazinës, veprim në papajtueshmëri me pikën 83, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Pas përfundimit të inventarizimit, komisioni nuk ka hartuar një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, duke përcaktuar kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues, veprim në papajtueshmëri me germën c pika 85, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (*Trajtuar në faqet 43-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5 – F. N., me detyrë specialiste Gjelbërimi, pasi:

- Në funksionin e kryetarit të komisionit të inventarizimit para fillimit të inventarit nuk ka mbajtur një procesverbal midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit për të fiksuar numri rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes së magazinës, veprim në papajtueshmëri me pikën 83, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Pas përfundimit të inventarizimit, komisioni nuk ka hartuar një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, duke përcaktuar kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues, veprim në papajtueshmëri me germën c pika 85, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (*Trajtuar në faqet 43-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6 – S. D., me detyrë specialiste finance, pasi:

- Në funksionin e kryetarit të komisionit të inventarizimit para fillimit të inventarit nuk ka mbajtur një procesverbal midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit për të fiksuar numri rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes së magazinës, veprim në papajtueshmëri me pikën 83, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Pas përfundimit të inventarizimit, komisioni nuk ka hartuar një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, duke përcaktuar kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues, veprim në papajtueshmëri me germën c pika 85, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (*Trajtuar në faqet 43-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7 – D. G., me detyrë inspektore për Arsim Kulturën, aktualisht specialiste arkive, pasi:

- Në funksionin e kryetarit të komisionit të inventarizimit para fillimit të inventarit nuk ka mbajtur një procesverbal midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit për të fiksuar numri rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes së magazinës, veprim në papajtueshmëri me pikën 83, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Pas përfundimit të inventarizimit, komisioni nuk ka hartuar një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, duke përcaktuar kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues, veprim në papajtueshmëri me germën c pika 85, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (*Trajtuar në faqet 43-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8 – E.H., me detyrë Përgjegjës i Qendrës Kulturore Krujë, pasi:

- Në një raste për pagesën e kryer në lidhje me ngjarjet kulturore të organizuar nga Bashkia Krujë, nuk ka hartuar një raport të hollësishëm për të gjithë procedurën e ndjekur, raport të cilin ia paraqet titullarit të institucionit, në kundërshtim me nenin 12 pika 3, të ligjit nr. 10296, datë

08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe VKM nr. 1173, datë 06.11.2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura” (*Trajtuar në faqet 31-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9 – D. M., me detyrë Specialist për marrëdhëniet me publikun, pasi:

- Në një raste për pagesën e kryer në lidhje me ngjarjet kulturore të organizuar nga Bashkia Krujë, nuk ka hartuar një raport të hollësishëm për të gjithë procedurën e ndjekur, raport të cilin ia paraqet titullarit të institucionit, në kundërshtim me nenin 12 pika 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe VKM nr. 1173, datë 06.11.2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura” (*Trajtuar në faqet 31-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10 – A. P., me detyrë inspektor prokurimesh, pasi:

- Në prokurimin me objekt: “Blerje dru zjarri të prera për kopshtet dhe çerdhet e Bashkisë Krujë”, bashkëlidhur dokumentacionit nuk ndodhet licenca e operatorit ekonomik, kontrata e lidhur ndërmjet palëve, ku të përcaktohej natyra e shërbimit, objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit, që do kryhet. Nuk ndodhen dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe fotografitë, dëshmi të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar mostra të mallit, ku të gjykonte për vlerësimin e ofertës teknik, në kundërshtim me germa a pika 1 kreu VI, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimeve publike”, të ndryshuar (*Trajtuar në faqet 21-22, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11 – A. H., me detyrë inspektore për Barazinë Gjinore, pasi:

- Në 2 raste për pagesën e kryer në lidhje me ngjarjet kulturore të organizuar nga Bashkia Krujë, në kundërshtim me nenin 12 pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe VKM nr. 1173, datë 06.11.2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura” (*Trajtuar në faqet 26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12 – B. Q., me detyrë ish-Përgjegjëse e Sektorit Menaxhimit, Mbrojtjes Tokës, Pronës, aktualisht Inspektore Pronave e Aseteve, pasi:

Nuk ka lidhur kontrata qiraje, për objekte të cilat janë zaptuar nga persona të ndryshëm të cilët i përdorin për strehim apo për qëllime biznesi, me sipërfaqe 10533.5 m², në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.06.2011 i ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (*Trajtuar në faqet 126-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13 – Sh. M., me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit Menaxhimit, Mbrojtjes Tokës, Pronës, aktualisht Inspektore i Menaxhimit të Tokës, pasi:

Nuk ka lidhur kontrata qiraje, për objekte të cilat janë zaptuar nga persona të ndryshëm të cilët i përdorin për strehim apo për qëllime biznesi, me sipërfaqe 10533.5 m², në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.06.2011 i ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (*Trajtuar në faqet 126-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

E. 2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës:

Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, neni 11, **i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore “Zgjidhje të kontratës së punës” për 2 punonjës si më poshtë:**

1 – A. T., me detyrë Inspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, me arsim Inxhinier Mekanike, pasi emërimi nuk është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

2 – F.K., me detyrë Inspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, me arsim Ekonomist, pasi emërimi nuk është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

E. 3. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germa e dhe ç neni 11, kreu IV, neni 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe neni 11 e 12, të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur dhënien e masave disiplinore “**Vërejtje**”, për **3 punonjës** si më poshtë:

1 – N. H., me detyrë magazinierë, pasi:

- Shkarkimin e magazinës në lidhje me materialet e asgjësuar është kryer në mënyrë fiktive, pasi fletë dalja nr. 141, datë 10.0.2017, me vlerë 24,40,991 lekë, nuk ka marrës në dorëzim të materialeve për asgjësim, këto materialet janë bërë dalje nga magazina vetëm me nënshkrimin e magazinieres, në kundërshtim me germën dh, e ë, pika 3, nenin 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe pikën 36, 37, 39, 40, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar dhe Urdhrin nr. 250, datë 07.03.2017 të Kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e komisionit të asgjësimit për materialet jashtë përdorimit” (*Trajtuar në faqen 33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2 – Q.L., me detyrë Drejtor i Administrimit të Territorit, Aseteve, Pronave të Paluajtshme, pasi:

Nuk ka lidhur kontrata qiraje, për objekte të cilat janë zaptuar nga persona të ndryshëm të cilët i përdorin për strehim apo për qëllime biznesi, me sipërfaqe 10533.5 m², në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.06.2011 i ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (*Trajtuar në faqen 130-133, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3 – B.S., me detyrë Specialist Pyjesh nga data 16.09.2016 deri me datë 01.02.2017 e më pas Përgjegjës i Sektorit të Pyjeve, pasi:

- Nuk ka zbatuar procedurat për heqjen nga fondi pyjorë të sipërfaqeve të dhëna për shfrytëzim për nxjerrjen e gurit gëlqeror dhe argjilave në sipërfaqen 627.725 ha, pronë (aset) i Bashkisë Krujë, në kundërshtim me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me pikat 3, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, ndryshuar pikat 3, 6, 7, 9, 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”, i ndryshuar (*Trajtuar në faqen 130-133, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

F. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, (Njësia e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionarin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

***Shënim: Për punonjësit e larguar.**

- Për 9 ish-punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara do të ishte kërkuar masë disiplinore, përkatësisht:

1. Sh. H., me detyrë Kryetar Bashkie, larguar nga puna me datë 31.07.2015,
2. A.T., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Arsim Kulturës, larguar me datë 01.03.2016,
3. B. R., me detyrë ish-Përgjegjës i Arsim Kulturës, larguar me datë 01.03.2016,
4. D.Ll., me detyrë Inspektore Kontabiliteti, larguar nga puna me datë 30.04.2016,
5. N.Ll., me detyrë arkëtare, larguar nga puna me datë 05.01.2016,
6. S.M., me detyrë Përgjegjës Finance, larguar nga puna me datë 02.11.2015,
7. B. D., me detyrë Përgjegjës Finance, larguara nga puna me datë 02.11.2015,
8. A. N., me detyrë Drejtor Arsim Kulturë Sport, larguara nga puna me datë 02.11.2015,
9. O.P., me detyrë Përgjegjës Sektorit të Tatim Taksave, larguar me datë 01.02.2016.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R